

KUSHTET E PJESMARRJES NË OAS

- 1.** Aplikanti duhet të jetë mbi 18 vjeç dhe nën 30 vjeç në datën e aplikimit për të hyrë në konkurim.
- 2.** Aplikanti duhet të ketë studiuar apo të studiojë në arte dhe dizajn dhe nuk duhet të ketë një marrëveshje përfaqësimi ekskluziv me një galeri tjetër.
- 3.** Aplikanti duhet të ketë në pronësi veprat e prezantuara .
- 4.** Aplikanti duhet të mbajë të gjitha të drejtat e pronësisë morale dhe intelektuale.
- 5.** Imazhi i paraqitur për aplikim duhet të prezantojë me saktësi veprën e artit.
- 6.** Aplikanti duhet të ketë në dispozicion veprat për t'u parë fizikisht nga Juria gjatë procesit të vlerësimit.
- 7.** Aplikanti, në rast se përzgjidhet, është përgjegjës për venien e veprave në korniza si dhe për shpenzimet e transportit në Galeri.
- 8.** Gallery70 rezervon të drejtën të hedhë poshtë veprat e artit që konsiderohen të papërshtatshme për ekspozitë, sipas gjykimit të saj.
- 9.** Kurimi i ekspozitës do të bëhet nga Galeria.
- 10.** Formati i prezantimit do të bëhet në dakortesi midis galerisë dhe artistit.
- 11.** Veprat e prezantuara duhet të jenë në dispozicion ekskluziv të Gallery70 për shitje gjatë gjithë ekspozitës si dhe periudhes së prezantimit në ARTSY me afat deri në 1 vit. Galeria dhe Artisti do të nënshkruajnë një marrëveshje për këtë qëllim.
- 12.** Duke aplikuar, pjesëmarrësit i japin Gallery70 lejen për të përdorur imazhin e veprës artistike në materialet promovuese për këtë projekt .
- 13.** Të gjithë aplikantët japin leje që pamjet nga ceremonia e hapjes dhe ekspozita mund të përdoren për promovimet e ardhshme nga galeria. Të drejtat për çdo vepër arti qëndrojnë te artisti.
- 14.** Aplikantët bien dakort që të dhënat e tyre të adresës elektronike do të përdoren nga galeria dhe sponsorët (nëse do të ketë) e tyre për t'i informuar ata rreth mundësive të reja në të ardhmen.
- 15.** Duke aplikuar në thirrjen e hapur, artistët e përzgjedhur pranojnë të kontaktohen në çdo pikë para dhe gjatë ekspozitës. Ju lutemi sigurohuni që të na jepni adresat e sakta të emailit dhe numrat e telefonit dhe të na njoftoni nëse do të ketë ndryshime.
- 16.** Të gjithë aplikantët bien dakort që të bëjnë maksimumin e tyre për të qenë të pranishëm gjatë hapjes së ekspozitës dhe aktiviteteve të tjera që galeria do të organizojë në kuadër të thirrjes së hapur.
- 17.** Artistëve të përzgjedhur për ekspozim do t'u kërkohet të lexojnë me kujdes dhe të bien dakort me marrëveshjen e pjesëmarrjes në ekspozitë ku specifikohen detyrimet e tyre për t'u listuar / ekspozuar dhe promovuar.
- 18.** Kjo thirrje i drejtohet artistëve të rinj me kombësi shqiptare
- 19.** Afati i fundit i aplikimit është 30 prill 2020 dhe aplikimi bëhet vetëm me email në adresën oas@gallery70.art . Cdo formë tjetër aplikimi nuk do të konsiderohe.
- 20.** Aplikimi është falas